

VENDIM
Nr. 63, datë 23.4.2019

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE NR. 179, DATË 8.11.2017, “MBI CERTIFIKIMIN E SHOQËRISË ‘OPERATORI I KOMBINUAR I GAZIT NATYROR’ ALBGAS SHA”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 37, nenit 50, nenit 59, nenit 68, dhe nenit 80, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, nenit 113, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, nenit 6, nenit 7, nenit 8, nenit 9, nenit 10 dhe nenit 11 të “Rregullores për certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Gazit Natyror”, miratuar me vendimin nr. 100, datë 5.8.2015, të Bordit të ERE-s dhe ndryshuar me vendimin nr. 129, datë 31.10.2015, si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.4.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përpiluar nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut në lidhje me një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 179, datë 8.11.2017, “Mbi certifikimin e shoqërisë ‘Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror Albgaz sh.a.’”, të ndryshuar,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 236, datë 2.11.2018, vendosi:

1. Afatet e përcaktuara në pikat 2, 3, 5, 5.2 dhe 7, të dispozitivit të vendimit nr. 179, datë 8.11.2017, “Mbi certifikimin e shoqërisë ‘Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror Albgaz sh.a.’”, të shtyhen deri në datën 10.4.2019.

2. Afati i përcaktuar në pikën 4, “... si dhe duhet që të hartojë dhe t’i dorëzojë ERE-s, raportin e përcaktuar sipas Programit të Përputhshmërisë rregullatore jo më vonë se 12 muaj nga miratimi i vendimit të certifikimit të “Albgaz” sh.a., konform përcaktimeve të nenit 21, të direktivës nr. 73/2009, të Komisionit Evropian, “Mbi rregullat për tregun e gazit natyror” dhe nenit 47, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, shtyhet deri në datën 10.4.2019. “Për një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 179, datë 8.11.2017, “Mbi certifikimin e shoqërisë ‘Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror Albgaz sh.a.’”.

- Shtyrja e këtij afati të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 236, datë 2.11.2018, u bë pasi u provua nga ana e shoqërisë “Albgaz” sh.a., pamundësia për të përmbushur të gjitha kushtet brenda afatit të përcaktuar në vendimin nr. 179, datë 8.11.2017, “Mbi certifikimin e shoqërisë ‘Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror Albgaz sh.a.’”.

- Shoqëria “Albgaz” sh.a. ende nuk i ka përmbushur tërësisht kërkesat e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 179, datë 8.11.2017, “Mbi certifikimin e shoqërisë ‘Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror Albgaz sh.a.’”, të ndryshuar, si vijon:

- Në lidhje me përmbushjen e kushteve të parashikuara në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 179, datë 8.11.2017, “Mbi certifikimin e shoqërisë ‘Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror Albgaz sh.a.’” konstatojmë sa parashikuar dhe sa realizuar si në vijim:

- Pika 2 e dispozitivit të vendimit nr. 179, datë 8.11.2017.

- Brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, “Albgaz” sh.a. të zëvendësojë përfaqësuesit e MIE-it të Këshilli Mbikëqyrës i kompanisë me anëtarë të cilët nuk janë të punësuar te MIE ose te kompanitë e prodhimit dhe/ose furnizimit të energjisë elektrike që kontrollohen nga ajo.

- Pas vendimarrjes së ERE-s nr. 179, datë 8.11.2017, “Mbi certifikimin e shoqërisë ‘Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror’”, për plotësimin e pikës 2 të saj, audituesi financiar i “Albgaz” sh.a. duhet të jetë i pavarur, në kuptimin që audituesi financiar nuk mund të jetë i njëjti subjekt që kryen detyra ose kryen auditimin e ndërmarrjeve/sipërmarrjeve që kryejnë ndonjë nga

veprimtaritë e prodhimit apo furnizimit të gazit natyror. Në lidhje me këtë çështje, “Albgaz” sh.a. duhet t’i kërkojë Asamblesë së Përgjithshme (MEF) sigurimin e shmangies së emërimeve të audituesve financiarë të njëjtë, rezulton se “Albgaz” sh.a. ka bërë ndryshimin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës në zbatim të urdhrit nr. 130, datë 14.11.2017 dhe urdhrit nr. 234, datë 6.3.2018, i ndryshuar.

- Pika 3 e dispozitivit të vendimit nr. 179, datë 8.11.2017.

“Albgaz” sh.a. të raportojë çdo muaj në ERE procedurën për regjistrimin e aseteve të transmetimit dhe ta përfundojë procedurën brenda gjashtë muajve pas miratimit të vendimit përfundimtar.

Në lidhje me plotësimin e këtij kushti nga korrespondencat e shoqërisë “Albgaz” sh.a. në ERE, si dhe me të fundit nr. 266, datë 1.4.2018, shoqëria ka bërë me dije që shoqëria “Albgaz” është pajisur me certifikatën e pronësisë, për:

1. Sheq i Madh (data e lëshimit të certifikatës 9.8.2017);
2. Fier Drizë truall me nr. pasurie 93 (data e lëshimit të certifikatës 9.11.2017);
3. Fier Gjonçe truall me nr. pasurie 267/10 (data e lëshimit të certifikatës 9.11.2017);
4. Lavdan, Mallakastër me nr. pasurie 549 (data e lëshimit të certifikatës 18.12.2017).

Në përgjigje të shkresës së ERE-s me nr. 266/1 prot., datë 5.4.2019, ka përcjellë praktikë dokumentare në lidhje aplikimin e vitit 2018, pranë ZRVPP-së për pajisjen me dokument pronësie për tri pasuri dhe është në pritje të përgjigjes nga ZVRP-ja përkatëse.

- Cërrik Elbasan, me nr. pasurie 12/289;
- Drenovë, Mallakastër, me nr. 1/6 pasurie;
- Balldren, Elbasan, me nr. A pasurie, e ndodhur në zonën kadastrale nr. 10/85.

Pika 4 e dispozitivit të vendimit nr. 179, datë 8.11.2017.

Brenda 3 muajve pas miratimit të vendimit të certifikimit, “Albgaz” sh.a. të caktojë Zyrtarin e Përputhshmërisë subjekt i miratimit nga ERE, si dhe duhet që të hartojë dhe t’i dorëzojë ERE-s, Raportin e përcaktuar sipas Programit të Përputhshmërisë rregullatore jo më vonë se 12 muaj nga miratimi i vendimit të certifikimit të “Albgaz” sh.a., konform përcaktimeve të nenit 21 të direktivës nr.73/2009 të Komisionit Evropian, “Mbi rregullat për tregun e gazit natyror” dhe nenit 47, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

Në lidhje me këtë kusht rezulton se ERE, me vendimin nr. 77, datë 26.5.2017, ka miratuar Programin e Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për gazin natyror, në germën “C”, pika 73, të të cilit sanksionohet se: “Çdo vit, jo më vonë se data [31 mars], zyrtari i përputhshmërisë duhet të përgatisë dhe dorëzojë në ERE një raport për përputhshmërinë e OST-së me këtë program, i cili duhet të publikohet në faqen e internetit të OST-së dhe të ERE-së”.

Në seksionin VII, pika 76, e programit të përputhshmërisë, citohet se: Ky program duhet të miratohet me vendimin e [organit përgjegjës] të kompanisë OST dhe, brenda 5 (pesë) ditëve pas përshtatjes së tij ky vendim duhet të dorëzohet në ERE për miratim. Ky Program duhet të hyjë në fuqi ditën tjetër pas miratimit nga ERE.

Në lidhje me këtë kusht Shoqëria Albgaz sh.a. s’ka asnjë pengesë që të dorëzojë për miratim në ERE, Programin e Përputhshmërisë të përshtatur sipas atij të miratuar nga ERE me vendimin nr. 77, datë 26.5.2017. “Mbi miratimin e Programit të Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror”.

Pika 5 e dispozitivit të vendimit nr. 179, datë 8.11.2017.

Brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, për qëllime të implementimit të rekomandimeve në Opinionin e Sekretariatit, “Albgaz” sh.a., të paraqesë në ERE dëshmi që tregon garancinë në lidhje me:

5.1 Pavarësinë e Auditueseve Financiarë Audituesi financiar i “Albgaz” sh.a. duhet të jetë i pavarur, nënkuptimin që audituesi financiar nuk mund të jetë i njëjti subjekt që kryen detyra ose

kryen auditimin e ndërmarrjeve/sipërmarrjeve që kryejnë ndonjë nga veprimtaritë e prodhimit apo furnizimit të gazit natyror. Në lidhje me këtë çështje, “Albgaz” sh.a. duhet t’i kërkojë Asamblesë së Përgjithshme sigurimin e shmangies së emërimeve të audituesve financiarë të njëjtë.

Sa i përket kushtit të vendosur në pikën 5.1 të vendimit nr. 179, datë 8.11.2017, në lidhje me pavarësinë e audituesve financiarë, rezulton se shoqëria “Albgaz” sh.a. ka depozituar në ERE dy deklarata për punonjësit e auditimit të “Albgaz” sh.a. në funksion të ndarjes së aktiviteteve në ndërmarrjet e energjisë lidhur me prodhimin dhe/ose furnizimin me gaz natyror. Këto struktura kryejnë veprimtarinë e auditimit të brendshëm të shoqërisë.

Nga faqja zyrtare e Qendrës Kombëtare të Biznesit rezulton se shoqëria “Albgaz” sh.a. ka depozituar pasqyrat financiare për vitin 2017, të nënshkruara nga tre ekspertë kontabël të cilët janë të ndryshëm nga ata të emëruar e që kryejnë këtë veprimtari për “Albpetrol” sh.a.

Sa më sipër plotëson kushtin e ndarjes së detyrës së auditimit financiar të shoqërisë, në pavarësi nga “Albpetrol” sh.a.

Plotësimi i kushteve sa më sipër, nuk çliron “Albgaz” sh.a. nga detyrimi për të raportuar në ERE çdo vit për audituesit ligjorë që kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore të vitit, në zbatim të vendimit nr. 179, datë 8.11.2017 dhe ligjit nr. 47/2016, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10091, datë 5.3.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Ekspertit Kontabël të regjistruar dhe të Kontabilistit të miratuar”, të ndryshuar.

- 5.2 dispozitivit të vendimit nr. 179, datë 8.11.2017

- Bashkëpunimin ndërinstitucional për realizimin e ndryshimeve në kuadrin ligjor, nenet 11 dhe 46 (10) i ligjit për sektorin e gazit natyror dhe transferimi i kompetencave te Ministria e Ekonomisë. Për përmbushjen e këtij detyrimi, “Albgaz” sh.a. do t’i paraqesë ERE-s provat dokumentare që ndryshimet ligjore dhe nënligjore të nevojshme që lidhen me transferimin e kompetencave të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë tek aksionari i “Albgaz” sh.a., Ministria e Ekonomisë dhe Financave, kanë ndodhur janë efektive.

Sa i përket kushtit të vendosur në pikën 5.2, të vendimit nr. 179, datë 8.11.2017, për bashkëpunimin ndërinstitucional për realizimin e ndryshimeve në kuadrin ligjor, nenet 11 dhe 46 (10) i ligjit për sektorin e gazit natyror dhe transferimi i kompetencave te Ministria e Ekonomisë, shoqëria “Albgaz” sh.a. ka përcjellë pranë MIE-it kërkesën me nr. 125 prot., datë 5.11.2018, ku, ndër të tjera, ka kërkuar zgjidhje edhe për plotësimin e këtij kushti, por nuk ka ende asnjë përgjigje prej saj.

Veç sa më sipër edhe ERE, së fundmi, me shkresën nr. 233/2 prot., datë 20.4.2018, ka kërkuar mbështetjen e MIE-it për zbatimin e parashikimeve të vendimit të certifikimit të “Albgaz” sh.a.

Në vijim të raportimit dhe konstatimeve sa më sipër, për shkak të rrethanave të cilat siç shpjeguar nuk varen nga vullneti i “Albgaz” sh.a. për të zbatuar parashikimet e vendimit të ERE-s nr. 179, datë 8.11.2017, ky i fundit i është drejtuar ERE-s, me kërkesën për shtyrjen e afatit të dërgimit të dokumentacionit të kërkuar nga vendimi nr. 179, datë 8.11.2017, deri në datën 20.12.2019, dhe bën me dije se po merr të gjitha masat e nevojshme për plotësimin e pikave të kërkuara në këtë vendim.

Në lidhje me këtë kërkesë, Kodi i Procedurave Administrative, neni 53 i tij parashikon që: afati i caktuar nga organi publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarimit të afatit.

Konstatojmë se ndodhemi në këto kushte, pasi kërkesa e “Albgaz” sh.a. është depozituar në ERE me shkresën nr. 266, datë 1.4.2019, dhe duke marrë në konsideratë që afati i vendosur në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 179, datë 8.11.2017, i ndryshuar, plotësohet në datën 10.4.2019, shqyrtimi i kësaj kërkesë përpara përfundimit të afatit, plotëson kushtet sa më sipër.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 2 e dispozitivit të vendimit nr. 179, datë 8.11.2017, të Bordit të ERE-s, shfuqizohet.
2. Pika 3 e vendimit nr. 179, datë 8.11.2017, të Bordit të ERE-s, ndryshon dhe bëhet: “3. “Albgaz” sh.a. të përfundojë brenda tre muajve procedurat e aplikimit pranë institucioneve përgjegjëse për pajisjen me certifikata pronësie për të gjitha asetete që disponon.”.
3. Pika 4, e vendimit nr. 179, datë 8.11.2017, të Bordit të ERE-s, ndryshon dhe bëhet: “Shoqëria “Albgaz” sh.a. të dorëzojë për miratim në ERE deri në datën 31 maj 2019, programin e përputhshmërisë të përshtatur sipas atij të miratuar nga ERE, me vendimin nr. 77, datë 26.5.2017, e Bordit të ERE-s, “Mbi miratimin e Programit të Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror”.
4. Pika 5.1, e vendimit nr. 179, datë 8.11.2017, të Bordit të ERE-s, ndryshohet dhe bëhet: ““Albgaz” sh.a. të paraqesë në ERE deklaratat e audituesve financiarë dhe pasqyrat financiare të shoqërisë çdo vit ushtrimor.”.
5. Afati i përcaktuar në pikën 5.2, të vendimit nr. 179, datë 8.11.2017, të Bordit të ERE-s, të shtyhet deri në datën 20.12.2019.
6. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të përcjellë këtë vendim pranë “Albgaz” sh.a., Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë, si dhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.
Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti